

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1108/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti- anëtar, dhe Ardita Perçuku-Shyti- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1108/2021 të datës 13.12.2021 të parashtruar nga ankuesit të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat me adresë Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit/Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 25.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1108/2021 e datës 13.12.2021 e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesi ish i punësuar në Komunën e Gjakovës sipas Akt emërimit me numër Nr.112-14315 të datës 01.03.2012 në pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Sport”, me Vendimin me numer Nr.118/02-624 të datës 03.01.2020 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, ankuesit „Udhëheqës i Sektorit për Sport”, në Drejtorinë për Kulture Rini dhe Sport ne Komunën e Gjakovës, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 09.01.2020, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me këtë vendim ankuesit i është njohur edhe e drejta e pagesës së një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit e cila ankuesit i është kompensuar nga Komuna e Gjakoves , si dhe ankuesi ish i punësuar në Komunën e Gjakovës sipas Akt emërimit me numër Nr.112-14317 të datës 01.03.2012, në pozitën “Nëpunës administrativ”, me Vendimin me numër Nr.118/02-22992 të datës 09.11.2017 të Nënkyretarit të Komunës së Gjakovës, ankuesit „Nëpunës administrativ”, në kuadër të Drejtorisë për Kulture Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 18.11.2017, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me

ketë vendim ankuesit i është njohur edhe e drejta e pagesës se një page të njehershme në vlerën e pagës së fundit e cila ankuesit i është kompensuar nga Komuna e Gjakovës.

Ankuesit dhe përmes përfaqësuesit te autorizuar të tyre me datën 28.09.2021 kane parashtruar kërkesës me numër protokolli 01/120/0128650 për kompensimin e tri pagave përcjellëse pas pensionimit, shpërblimit jubilar, shujtës ditore si dhe pagës së (13)trembëdhjetë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës .

Komuna e Gjakovës me datën 01.10.2021 i është përgjigjur përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve në lidhje me kërkesën me numër protokolli 01/120/0128650 për kompensim material, duke cituar se *“planifikimi i pagave bëhet duke u mbështetur në limitet e kategorive ekonomike te përcaktuara nga qarkoret buxhetore te lëshuara nga Ministria e Financave, andaj edhe vlera e përcaktuar për kategorinë paga dhe mëditje nga qarkoret buxhetore nuk na lejon të buxhetojmë shtesa të tilla sepse ju dedikohet vetëm pagave të rregullta”*.

Ankuesit dhe të pakënaqur me përgjigjen nga Komuna e Gjakovës, përmes përfaqësuesit te autorizuar të tyre me datën 14.10.2021 kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave ligjore.

Me datën 15.10.2021 Komuna e Gjakovës, i ka kthyer përgjigjeje përmes se cilës ka sqaruar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk është kompetent për të vendosur për ankesat e ankuesve sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe se trajtimi i tyre është kompetence tanimë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës.

Ankuesit dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar të tyre me datën 13.12.2021 parashtrjnë ankesë me numër protokolli 6054 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ne lidhje me kompensimin e pagave përcjellëse pas pensionimit, pagave jubilarë, shujtës ditore si dhe pagës së trembëdhjetë (13).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 21.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Komunën e Gjakovës, ndërsa më datë 31.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjakovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6054/2021 të datës 13.12.2021 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 22.09.2021 për ankuesin Autorizimin e datës 22.09.2021 për ankuesin Kërkesën e datës 28.09.2021nga përfaqësuese për kompensim për Komunën e Gjakovës; Ankesën e ankuesve te datës 14.10.2021 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Aktgjykimin me numër A.nr.723/2017 nga Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën për përgjigje në ankesë te datës 21.12.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 31.12.2021 nga Komuna e Gjakovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës;

Akt emërimin e ankuesit të datës 29.02.2012; Akt emërimin e ankuesit të datës 29.02.2012; Kërkesën e datës 28.09.2021 nga përfaqësuesi i ankuesve për Komunën e Gjakovës; Përgjigjen në kërkesë e datës 01.10.2021 nga Komuna e Gjakovës; Dërgesën e datës 01.10.2021; Ankesën e ankuesve të datës 14.10.2021 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Sqarimin e datës 15.10.2021 nga Komuna e Gjakovës për përfaqësuesin e ankuesve; Dërgesën e datës 15.10.2021 ; Aktgjykimin me numër C.nr.618/20 të datës 27.07.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil; Vendimin me numër 01Nr.118/02-624 për pensionim të datës 03.01.2020 për ankuesin Vendimin me numër 01Nr.118/02-22992 për pensionim të datës 09.11.2017 për ankuesin

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueseve dhe është e pa lejuar, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se me Vendimin me numër Nr.118/02-624 të datës 03.01.2020 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, ankuesit „Udhëheqës i Sektorit për Sport“, në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 09.01.2020, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, po ashtu me Vendimin me numër Nr.118/02-22992 të datës 09.11.2017 të Nënkyetarit të Komunës së Gjakovës, ankuesit „Nëpunës administrativ“, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 18.11.2017, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Kolegji ka konstatuar se me këto vendime ankueseve ju është njohur e drejta e pagesës së një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit e cila i'u është kompensuar nga Komuna e Gjakovës.

Ankuesit dhe te pakënaqur me mos njohjen e të drejtës së pagesës së tri (3) pagave me rastin e pensionimit, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, përmes përfaqësuesit të autorizuar të tyre me datën 28.09.2021 kane parashtruar kërkesës për kompensimin e tri pagave përcjellëse pas pensionimit, shpërblimit jubilar, shujtës ditore si dhe pagës së (13)trembëdhjetë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, pas marrjes së përgjigjes së datës 01.10.2021 nga Komuna e Gjakovës , ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar të tyre me datën 14.10.2021 kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjakovës. Komuna e Gjakovës me datën 15.10.2021 është përgjigjur në ankesën e përfaqësuesit të ankuesve dhe ka sqaruar situatën se tanimë se me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik trajtimi i ankesave të nëpunësve civil është kompetencë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Njoftimin lidhur me mos shqyrtimin e ankesës nga ana e Komunës së Gjakovës përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve e ka pranuar me datën 18.10.2021, ndërsa me datën 13.12.2021 përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve ka parashtruar ankesën me numër protokolli 6054/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *jashtë afatit ligjor* të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin**




administrativ", në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa e ankueses është e palejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1108/2021

Ardita Perçuku-Shyti



Protesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

